



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO**  
**GJYKATA E APELIT PRISHTINË**

---

Numri i lëndës: 2022:262795  
Datë: 30.05.2024  
Numri i dokumentit: 05754287

AA.nr.710/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS-Departamenti për Çështje Administrative, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët; Hajriz Hoti kryetar, Ramiz Kuqi dhe Delushe Halimi anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale, Hajrije Krasniqi, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit, S.B, Komuna e Podujevës, kundër të paditurës, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale-Departamenti i Pensioneve, me seli në Prishtinë, me bazë juridike anulim i vendimit, përkitazi me ankesën e të paditurës, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.2846/2022, të datës;24.08.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë;20.05.2024, merr këtë,

**A K T V E N D I M**

Miratohet si e bazuar ankesa e të paditurës, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale-Departamenti i Pensioneve në Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.2846/2022, i datës;24.08.2023, priset dhe lënda i kthehet Gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje.

**A r s y e t i m**

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.2846/2022, të datës;24.08.2023, është vendosur, *“I. APROVOHET në tërësi kërkesëpadia e paditësit S.B, Komuna Podujevë, kundër të paditurës Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, si e bazuar. II. ANULOHET vendimi i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale i datës 08.07.2022 dhe vendimi i datës 28.10.2022. III. Paditësit i njihet e drejta në pension kontribut pagues të moshës nga data e parashtrimit të kërkesës dt.07.06.2022 dhe në vazhdim, DETYROHET e paditura Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale që paditësit S.B, Komuna Podujevë në mënyre retroaktive si pasoj e ekzekutimit të vendimit të kundërligjshëm t’i kompensoj diferencën në mes pension bazë dhe ati kontribut pagues të moshës me përgatitje shkollore të mesme dhe atë diferencën për muaj në shumë prej 98 euro ( nëntëdhjetë e tetë) nga data 07.06.2022 deri më datës 24.08.2023, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarrimit me dhunë, kurse nga data 25.08.2023 pagesa e pensionit kontribut pagues të moshës bëhet në baza mujore sipas shumës*

*që është e përcaktuar për këtë lloj pensioni, si pension më i favorshëm. IV. Ky aktgjykim zëvendëson aktin e anuluar dhe ka karakter të detyrueshëm.”*

Kundër këtij aktgjykimi ka ushtruar ankesë e paditura, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale-Departamenti i Pensioneve për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës administrative, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet si e bazuar ankesa e të paditurës dhe aktgjykimi i goditur të priset si dhe të mbeten në fuqi vendimi i të paditurës i datës;08.07.2022 dhe i datës;28.10.2022, kurse kërkesëpadia e paditësit të refuzohet në tërësi si e pa bazuar.

Përgjigje në ankesë nuk ka ushtruar pala paditëse.

Kolegji i Gjykatës së Apelit, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre duke u bazuar në nenin 49 paragrafi 1 të Ligjit për Konfliktet Administrative dhe nenit 194 dhe 195.1 pika d) të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative, ka gjetur se ankesa e të paditurës është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi, ka ushtruar padi për konflikt administrativ me datë;11.12.2022, kundër vendimit të paditurës, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale-Departamenti i Pensioneve, me çka kërkuar nga gjykata që të anulohet vendimin e të paditurës dhe paditësit ti njihet e drejta në pensionin kontribut pagues të moshës.

Gjykata e shkallës së parë, pas shqyrtimit të padisë së paditësit të paraqitur kundër vendimit të paditurës, dhe pas administrimit të provave si në procesverbal të seancës së shqyrtimit kryesor, bie aktgjykimin e ankimuar me të cilin e aprovon si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit, me arsyetim se “Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e aktvendimit të goditur në përputhje me nenin 43.3 të LKA-së dhe provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor, ku ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar dhe ka konstatuar se vendimet e atakuar nuk përmbajnë elementet e nenit 47 dhe 48 të Ligjit të Procedurës së Përgjithshme Administrative dhe si të tilla janë të kundërligjshme. Gjykata kishte parasysh nenin 25 paragrafi 1 të Ligjit 05/L-031 Për Skemat Pensionale Të Financuara Nga Shteti ( të referuar në vendimin e kundërshtuar) ku përcaktohet :” 1.5. çdo verifikim tjetër që Ministria e vlerëson si të arsyeshëm dhe të nevojshëm për të siguruar menaxhimin dhe administrimin e mirëfilltë të pensioneve”. Gjykata fillimisht iu edhe Ligjit për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti nr. 04/L-131, të referuar në vendimin e atakuar, konkretisht nenit 8 të këtij ligji i cili përcakton se: “Të drejtën në pension kontribut pagues të moshës e realizojnë të gjithë personat të cilët kanë shtetësi të Kosovës dhe të cilët; 1.1. Kanë mbushur moshën gjashtëdhjetë e pesë (65) vjeçare; 1.2.Duhet të ketë stazh pensional kontribut dhënës, sipas Ligjit për Sigurimin Pensional dhe Invalidor nr. 011-24/83 (Gazeta Zyrtare e KSAK nr. 26/83) para datës 01.01.1999; 1.3.Ofrojnë dëshmi të vlefshme mbi pagesën e kontributeve sipas dispozitave të Ligjit për Sigurimin Pensional dhe Invalidor nr. 011-24/83 (Gazeta Zyrtare e KSAK NR. 26/83) para datës 01.01.1999”, kurse me paragrafi 6 të nenit të sipërcituar përcaktohet se :”Me këtë ligj u njihet stazhi i punës për pension kontribut dhënës për vitet 1989-1999 punëtorëve të arsimit, të shëndetësisë dhe të tjerëve që kanë punuar në sistemin e Republikës së Kosovës”. Gjykata për të konstatuar si të kundërligjshëm vendimin e të paditurës kishte parasysh po ashtu edhe aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese Nr.ref.: AGJ 2113/23 datë 16 janar 2023 2 për faktin se me të njëjtin konstatohet se nenit 8 te Ligjit nr.04/L-131 për Skemat Pensionale te Financuara nga Shteti ne lidhje me nën paragrafin 2.3 te paragrafit 2 te nenit 6 te Udhëzimit Administrativ nr.09/2015 për Kategorizimin e Shfrytëzuesve të Pensionit Kontribut pagues sipas Strukturës Kualifikuese dhe Kohëzgjatjes se Pagesës se

*Kontributeve-Stazhit Pensional, nuk janë në përputhshmëri me nenin 24 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës në lidhje me nenin 14 (Ndalimi i diskriminimit) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe nenin 1 (Ndalimi i Përgjithshëm i Diskriminimit) të Protokollit nr. 12 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; kurse e paditura në vendimin kontestues referohet pikërisht në nenin 8 të Ligjit 04/L-131 lidhur me dëshmitë e pamjaftueshme të prezantuara. Nga shkresat e lëndës dhe konkretisht nga vet vendimi i të paditurës i datës 08.07.2022 nuk përcaktohet fare përvoja kontributive që është konstatuar nga e paditura, andaj është e paqartë se si e paditura më vendimin e datës 28.10.2022 ka konstatuar se këtu paditësi nuk i plotëson kushtet e parapara për realizimin e të drejtës në pension kontribut pagues, përderisa e njëjta me asnjë provë nuk ka dëshmuar se paditësi nuk i plotëson kushtet, andaj e paditura para Gjykatës ka dështuar të arsyetoj konstatimin e saj si në vendimin e atakuar. Gjykata duke pasur parasysh provat në shkresat e lëndës si vendim i dt. 28.10.2022, vërtetim i dt. 28.10.2188, letër konfirmimi, dt.31.05.2022, vendim i dt. 13.08.1990, akti i dt.21.01.1986, vendim i dt. 06.01.1999, kërkesë e dt.30.12.1998, vendim i dt.28.01.1992, kopje e librezës së punës, nr.5645, akt përcjellës i dt. 10.01.2023, ankesë e dt. 24.08.2022, vendim i dt.06.01.1998, nr.07/53, aktvendim nr.2926/88, aktvendim për caktimin e bazës për llogaritjen e të ardhurave personale, Nr.5902, dt. 16.08.1990, vendim i dt.09.07.1992, aktvendim për përcaktimin e bazës për llogaritjen e të ardhurave personale nr. i amz.88, aktvendim për përcaktimin bazës për përllogaritjen e të ardhurave personale dt. 08.02.1985, vendim mbi zgjedhjen e punëtorit, dt. 15.09.1983, vendim i dt. 08.07.2022, diplomë e dt. 11.02.1978, kopje e letërnjoftimit, vendim i dt. 06.02.1990, aktvendim mbi lejimin e mungesës nga puna me pagesë të të AP dt. 05.09.2002, shkresa e dt. 24.03.2006, nga Agresioni Kosovar i Mirëbesimit, vërtetim i të ardhurave personale dt. 26.11.2000, Nr. 693, letër konfirmim dt.31.05.2022, libreze shëndetësore 28.10.1990, kopje e regjistrit nga Libri amë (nuk identifikohet datë), vendim i dt.02.08.2021 dhe po ashtu duke ja falur besimin edhe dëshmitarit të dëgjuar në këtë shqyrtim gjyqësor, e lidhur me të cilat dëshmi Gjykata kishte në vëmendje paragrafin 6 të nenit 8 të Ligjit për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti në kuptim të njohjes së stazhit të punës për pension kontribut dhënës për vitet 1989-1999 punëtorëve të arsimit, të shëndetësisë dhe të tjerëve që kanë punuar në sistemin e Republikës së Kosovës, konstaton se paditësi i plotëson kërkesat ligjore për të ju njohur e drejta në pension kontribut pagues të moshës sepse mjaftueshëm është dëshmuar përvoja e punës, stazhi i punës në kuptim të nenit 8 par 6 të sipërcituar për punën në sistemin e Kosovës, duke ofruar mjaftueshëm të dhëna për kërkesën ligjore për 15 vite stazh kontributi, posaçërisht me librezën e punës nr.5645 ku përcaktohet data e inkuadrimit 03.11.1983 dhe data e prerjes së inkuadrimit 24.03.2006 –Fabrika e Armaturës dhe po ashtu letër konfirmimi i datës 31.05.2022 ku përcaktohet se paditësi ka filluar punën në ndërmarrjen shoqërore “F...” me datë 03.11.1983 deri më 24.03.2006. Po ashtu Gjykata kishte parasysh se nga provat e administruara, konstatohet se rreth pranimit të dëshmimeve për pension kontribut pagues për kategori të njëjtë të kontribut paguesve dhe me përvojën e njëjtë vetë e paditura ka aplikuar standarde të dyfishta, siç referohet rasti nga vendimi dorëzuar si provë i datës 02.08.2021. Pasi që gjykata vërtetoi këto fakte mbi bazën e provave në shkresat e lëndës si dhe në përputhje me dispozitat e ligjeve në fuqi, duke pasur në vëmendje vendimet e listuara të Gjykatave të rregullta dhe Gjykatës Kushtetuese po ashtu, vlerësoi se gjendja faktike ndryshon nga ajo që është vërtetuar në procedurën administrative pranë të paditurës. Duke marr për bazë këtë, gjykata ka vlerësuar se vendimi i të paditurës është i kundërligjshëm dhe si rezultat ka vendosur që paditësit t'i njihet e drejta në Pension Kontribut pagues të Moshës, nga dita e parashtrimit të kërkesës dhe ka vendosur të njëjtit t'i bëhet kompensimi në emër të kësaj të drejte në mënyrë retroaktive sipas diferencës së pensionit bazë që paditësi ka marrur dhe atij të pensionit kontribut pagues të moshës. Me nenin 2 paragrafi 2.1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore përcaktohet.” Në procedurë kontestimore gjykata vendos brenda kufijve të kërkesave që janë parashtruar nga palët ndërgjyqëse”, i zbatueshëm në kuptim të nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative,*

*lidhur me njohjen e të drejtës dhe kompensimin si në pikën II të dispozitivit të këtij vendimi. Lidhur me kompensimin e përcaktuar si në dispozitiv Gjykata kishte parasysh po ashtu nenin 26 të Ligjit për Konfliktet Administrative ku përcaktohet:” 2.3. kthimi i sendeve të marrura dhe kompensimi i dëmit i shkaktuar me ekzekutimin e aktit administrativ të kontestuar.”, dhe po ashtu nenin 46 të këtij Ligji ku përcaktohet:” 5. Me aktgjykim, me të cilin anulohet akti i kontestuar administrativ, gjykata do të vendosë edhe për kërkesën e paditësit për kthimin e sendit, respektivisht për kompensimin e dëmit, nëse të dhënat e procedurës japin për këtë gjë bazë të sigurt. Në të kundërtën, gjykata do ta udhëzojë paditësin që kërkesën e vet ta realizojë në procedurën kontestimore”. Për të vendosur në këtë mënyrë, lidhur me të Drejtën në Pension Kontribut pagues, gjykata konsideron se ky lloj pensioni është e drejtë themelore e njeriut dhe se nuk mund të ndahet nga pensioni bazë. Gjykata kishte parasysh edhe nenin 1, Protokollit Nr.1 të KEDNJ i cili në paragrafin 1, përcakton se: “Çdo person fizik ose juridik ka të drejtën e gëzimit paqësor të pasurisë së tij. Askush nuk mund të privohet nga prona e tij, përveçse për arsye të interesit publik dhe në kushtet e parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare”. Lidhur me këtë, në praktikën e GJEDNJ-së ekziston rasti Gaygusuz v Austria, i cili ka bërë lidhjen në mes të kontributeve dhe pensionit, ku ka konstatuar se paditësit Z. Cevat Gaygusuz, nuk mund t’i mohohet e drejta në pensionin kontribut dhënës, pasi që i njëjti ka paguar kontribute pensionale. Po ashtu, rasti Van Raalte v the Netherlands të datës 21.02.1997 dhe Bergervoet v the Netherlands të datës 04.09.2002.”*

Kolegji i Gjykatës të Apelit, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes dhe pas ekzaminimit të aktgjykimit të ankimuar dhe shkresave të lëndës, e duke i pasur parasysh edhe pretendimet ankimore, vëren se aktgjykimi i kontestuar është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika n) dhe neni 183 të LPK-së, se është juridikisht i paqartë dhe kundërthënës me vetveten dhe me arsyetimin e tij për çka në mënyrë të bazuar theksohet në ankesë. Prandaj pikëpamjet juridike të Gjykatës së shkallës së parë nuk mund ti përkrahë si të rregullta dhe të ligjshme për arsye se, arsyet në të cilat bazohen faktet vendimtare lidhur me mënyrën e vendosjes, janë jo të qëndrueshme dhe në kundërshtim me faktet të cilat e paditura i thekson në ankesë, e rrjedhimisht nga kjo edhe e drejta materiale nuk është zbatuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë.

Kolegji i apelit vëren se përmes aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës nr. KO190/19 të datës;30.12.2022, kërkesa e Gjykatës Supreme e Kosovës për vlerësimin e kushtetutshmërisë së nenit 8 par. 2 të Ligjit për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti nr.04/L-131 në lidhje me nenin 5 të Udhëzimit Administrativ nr.09/2015 për kategorizimin e shfrytëzuesve të pensionit kontributpagues sipas Strukturës Kualifikuese dhe Kohëzgjatjes së Pagesës së Kontributeve-stazhit pensional, është shpallur i pranueshëm. Është vërtetuar po ashtu se paragrafi 2 i nenit 8 të Ligjit nr.04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti në lidhje me nën paragrafin 2.3 të paragrafit 2 të nenit 6 të Udhëzimit Administrativ nr.09/2015 për Kategorizimin e Shfrytëzuesve të Pensionit Kontributpagues sipas Strukturës Kualifikuese dhe Kohëzgjatjes së Pagesës së Kontributeve-Stazhit Pensional, nuk janë në përputhshmëri me nenin 24 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës në lidhje me nenin 14 (Mbrojtja nga Diskriminimi) të KEDNJ-së dhe me nenin 1 (Ndalimi i përgjithshëm i diskriminimit) të Protokollit nr. 12 të KEDNJ-së , që në pajtim me paragrafin 5 te nenit 20 te Ligjit dhe paragrafin 5 te rregullit 60 te Rregullores se punës, paragrafi 2 i nenit 8 te Ligjit nr.04/L-131, për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti në lidhje me nën paragrafin 2.3, të paragrafit 2, të nenit 6 të Udhëzimit Administrativ, nr.09/2015, për Kategorizimin e Shfrytëzuesve të Pensionit Kontributpagues sipas Strukturës Kualifikuese dhe Kohëzgjatjes së Pagesës se Kontributeve-Stazhit Pensional, shfuqizohen me 15 korrik 2023, andaj në pajtim me paragrafin 1, të nenit 116, të Kushtetutës, urdhëron Kuvendin dhe Qeverinë e Republikës së Kosovës, që jo më larg se deri me 15 korrik 2023, të ndërmarrin veprimet e

nevojshme për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr.04/L-131, për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti në pajtim me Kushtetutën dhe këtë Aktgjykim. Në afatin që ka aprovuar Gjykata, institucionet relevante të Republikës së Kosovës, në radhë të parë Kuvendi dhe MPMS duhet të ndërmarrin masat përkatëse që dispozitat relevante të ligjit të kontestuar dhe të Udhëzimit Administrativ të zëvendësohen me dispozita që janë në pajtim me këtë aktgjykim dhe me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, me qëllim të kategorizimit të individëve që mund të përfitojnë nga skema pensionale e kontributpaguese të moshës për punën që kanë kryer para vitit 1999, e të cilët janë larguar nga puna si pasojë e masave diskriminuese.

Duke vepruar sipas këtij aktgjykimi, Kuvendi Republikës së Kosovës ka bërë Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L-131, për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti, me Ligjin Nr.08/L-248 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit NR.04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti, ku me nenin 3 të tij Fshihet paragrafi 2 dhe paragrafi 6 i nenit 8 të Ligjit Bazik. Të cilin nen Gjykata Kushtetuese e ka vlerësuar së është diskriminues. Kurse me nenin 4 pas nenit 8, është shtuar dispozita ligjore 8/A në Ligjin Bazik me tekstin si në vijim: *Neni 8/A Pensioni parcial kontributpagues i moshës 1. Personat që kanë kontribuar sipas Ligjit për Sigurimin Pensional dhe Invalidor Nr.011-24/83 (Gazeta Zyrtare e KSAK Nr. 26/83) para datës 01.01.1999 por nuk e arrijnë stazhin pensional prej pesëmbëdhjetë (15) vitesh kontribute si periudhë kushtëzuese për shkak se janë larguar nga puna si rezultat i masave të dhunshme, mund të kualifikohen në skemën e pensionit parcial kontributpagues të moshës sipas kriterëve dhe kushteve të përcaktuara në këtë nen. 2. Të drejtën në pension parcial kontributpagues të moshës e realizojnë të gjithë personat të cilët kanë shtetësi të Kosovës dhe të cilët plotësojnë kushtet në vijim: 2.1. kanë mbushur moshën gjashtëdhjetë e pesë (65) vjeçare; 2.2. ofrojnë dëshmi të vlefshme mbi pagesën e kontributeve sipas dispozitave të Ligjit për Sigurimin Pensional dhe Invalidor nr.011-24/83 (Gazeta Zyrtare e KSAK nr.26/83) para datës 01.01.1999; 2.3. janë larguar nga puna pas datës 01.01.1989 si rezultat i masave të dhunshme; 2.4. shuma e periudhës së kontributeve të paguara sipas nën-paragrafit 2.2 si dhe periudhës nga data e largimit të dhunshëm nga puna sipas nën-paragrafit 2.3 e deri më 01.01.1999 bashkërisht arrijnë nivelin prej pesëmbëdhjetë (15) vitesh. 3. Dokumentacioni i nevojshëm për të plotësuar kushtet e paragrafit 2 të këtij neni përcaktohet me akt nënligjor nga ministri. 4. Lartësia e pensionit parcial kontributpagues për secilin nivel përcaktohet në përputhje me procedurën e vendosur me nenin 13 të Ligjit Bazik, duke marrë për bazë numrin e viteve të kontributeve të paguara sipas nën-paragrafit 2.2 të këtij neni.”*

Me provat e administruara në seancën e shqyrtimit kryesor nga Gjykata shkallës së parë, kolegji apelit verën se paditësi nuk ka dëshmi të vlefshme prej 15 viteve për pagesën e kontributeve pensionale para datës;01.01.1999, sipas dispozitave të Ligjit për Sigurimin Pensional dhe Invalidor nr.011-24/83 (Gazeta Zyrtare e KSAK nr.26/83) para datës;01.01.1999, dhe Ligjit NR.08/L-248 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit NR.04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuar nga Shteti, e jo siç ka nxjerrë përfundim Gjykata e shkallës së parë, kur ka konstatuar se “Gjykata duke pasur parasysh provat në shkresat e lëndës si deklaratë për bashkësinë familjare dt.02.06.2022, vendim i dt.09.07.2020, kopje e Librezës së punës Nr.3305, vendim i dt.10.03.2022, vendim i dt.19.05.2022, vendim i dt.20.05.1993, nr.793, transfer dt.01.06.2020, pagesa 01.06.202,30.06.2020, letër konfirmim 03.06.202, bëjnë të papranueshme për Gjykatën konstatimi si në vendimin e atakuar duke neglizhuar kështu dhe fare duke mos e marrë parasysh këtë përvojë punë të këtu paditësit si në letër konfirmim e AKP si dhe kopjen e librezës së punës mbi përvojën e punës të këtu paditësit në ndërmarrjen shoqërore M... IMB sipas letër konfirmimit dhe faktin se paditësi nuk e ka ndërruar punëdhënësin, në këtë në kuptim Gjykata vëren se paditësi i plotëson kërkesat ligjore për t’iu njohur e drejta e kërkuar, kjo për faktin se me provat të cilat gjinden në shkresat e lëndës vëren se paditësi ka punuar te i njëjti punëdhënës,

*përkatësisht ndërmarrja shoqërore M... IMB, por e paditura nuk e ka marrë fare parasysh këtë fakt krahas përvojës së konstatuar nga vet e paditura, për të vendosur në mënyrë të drejtë dhe të plotë këtë çështje. Në këtë kuptim Gjykata ja fali besimin provave të administruara në shqyrtim gjyqësor, andaj në vështrim të Ligjit për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti në kuptim të njohjes së stazhit të punës për pension kontributdhënës për vitet 1989-1999 punëtorëve të arsimit, të shëndetësisë dhe të tjerëve që kanë punuar në sistemin e Republikës së Kosovës, konstaton se paditësi i plotëson kërkesat ligjore për të ju njohur e drejta në pension kontribut pagues të moshës sepse mjaftueshëm është dëshmuar përvoja e punës, stazhi i punës për punën në sistemin e Kosovës, duke ofruar mjaftueshëm të dhëna për kërkesën ligjore për 15 vite stazh kontributiv.”*

Prandaj, kolegji i apelit tani për tani nuk mund të pranoj si të drejtë një qëndrim të tillë të paraqitur në aktgjykimin e ankimuar, sepse ka të meta të tilla për shkak të cilave nuk mund të ekzaminohet, dhe se i njëjti është juridikisht i pa qartë dhe kundërthënës me vetveten dhe me arsyetimin e tij, dhe me provat e mangëta dhe të pa administruara, dhe të pa vlerësuar nga Gjykata e shkallës së parë, në drejtim të kontributeve të paguara pensionale nga paditësi, edhe pse i njëjti ka përvojë të mjaftueshme të punës, por nuk ka dëshmi që e vërtetojnë faktin se i njëjti i ka paguar kontributet pensionale për periudhën sa është kërkuar me ligj.

Për arsyet e dhëna më lart, aktgjykimi i kundërshtuar është dashur të prishet dhe çështja t’i kthehet Gjykatës së shkallës së parë në rigjykim, për t’i mënjeluar shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika n) dhe neni 183 të LPK-së, që janë të tilla që pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së aktgjykimit të kontestuar nga e paditura.

Mbi këto arsye, detyrohet Gjykata e shkallës së parë që në ri procedurë të mënjanoj mangësitë e paraqitura më lartë, përkatësisht të kërkoj sipas detyrës zyrtare nga paditësi, organi i paditur, Ministria e Financave, Punës dhe Tranfereve-Departamenti i Pensioneve, dhe si nga organi i punësimit, Ndërmarrja Shoqërore (NSH) “F...”, tani me emërtim të ri “F...” në Podujevë, që të provojnë para Gjykatës se paditësi ka paguar kontributet pensionale, përkatësisht ka stazh kontribut pagues për 15 vite deri më 01.01.1999, ashtu siç është përcaktuar me Ligjin Nr.08/L-248 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti. Kjo për faktin se paditësi nuk hynë në kategorinë e personave që është larguar nga puna si rezultat i masave të dhunshme, për t’iu njohur e drejta në pension parcial kontribut pagues ashtu siç është përcaktuar me ligjin e ndryshuar, sepse vetëm kategorisë se personave të larguar me dhunë nga puna, ligji i ndryshuar dhe plotësuar i’a njuhë të drejtën në pension parcial, kurse paditësi, organi i paditur dhe organi i punësimit, duhet të provojnë para Gjykatës se paditësi ka paguar kontributet pensionale, përkatësisht ka stazh kontribut pagues 15 vite deri më datë:01.01.1999, dhe varësisht nga gjendja e vërtetuar faktike pas marrjes së kësaj prove, dhe përmes zbatimit të drejtë të së drejtës materiale, përkatësisht Ligjin Nr.08/L-248 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit NR.04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti, të vendos sipas padisë së paditësit, dhe më pas të nxjerr aktgjykim të drejtë dhe të ligjshëm.

Mbi këto arsye Gjykata ka mundësi të bie aktgjykim të drejtë dhe të ligjshëm në kuptim të dispozitave të nenit 8A të Ligjit Nr.08/L-248 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit NR.04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti.

Mbi këtë bazë, e në mbështetje të nenit 49 të Ligjit për Konfliktet Administrative, si dhe nenit 195 paragrafi 1 pika c), të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Numri i lëndës: 2022:262795  
Datë: 30.05.2024  
Numri i dokumentit: 05754287

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË  
AA.nr.710/2023, datë;20.05.2024

Kryetari i kolegjit,  
Hajriz Hoti